



qendra e provimeve

MASA
E VËRTETË
E NJOHURIVE

GARAT SHTETËRORE 2014

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE, KLASA VI

MATEMATIKË

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrollloi

.....

.....

Podgoricë, 20.....

UDHËZIME PËR PUNË

Tani do të zhvilloni detyra nga lënda e **matematikës** që e keni mësuar në klasat e mëparshme. Duhet të tregoni shkathtësi në zbatimin e njohurive të fituara. Për këtë është e nevojshme të punoni me angazhim të plotë, në mënyrë që të tregoni sukses sa më të mirë. Detyrat nuk kërkojnë llogaritje të gjata, por para së gjithash **përfundim logjik**.

Rendi i zhvillimit të detyrave nuk është me rëndësi. Nëse ndonjë detyrë ju duket tepër e rëndë, mos u ndalni shumë në të, por kaloni në detyrën tjetër. Nëse ju mbetet kohë, shfrytëzoheni atë sa më mirë, d.m.th. kthejuni përsëri në detyrat të cilat nuk i keni zhvilluar dhe provoni t'i zgjidhni ato.

Shkruani lexueshëm, sidomos numrat!

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk është e lejueshme asnjë lloj bisede. Nëse ndokush në mënyra të ndryshme pengon punën e tjerëve, do të përjashtohet nga garat.

Gjatë punës tuaj mund të përdorni veglat shkollore për vizatimin e figurave gjeometrike, por nuk është i lejueshëm përdorimi i telefonave celularë, llogaritësve dhe mjeteve tjera elektronike ndihmëse.

Për çdo detyrë janë paraparë nga 25 pikë.

Për zhvillimin e testit keni 180 minuta.

Mund të filloni nga puna. **Me fat!**

DETYRAT

1. Caktoni të gjithë numrat njëshifror natyror a , b dhe c , ashtu që

$$\frac{2}{a} + \frac{b}{3} = \frac{23+c}{21}.$$

2. Një paketim i çokolatave të vogla ka vlerën e 1,5€ dhe gjysmës së atij paketimi. Sa kushtojnë 3 e gjysmë paketime të filla të çokolatave të vogla?

3. Kur paralelopipedi, një brinjë e të cilit ka gjatësinë 8 cm, të ndahet në 4 pjesë të barabarta fitohen 4 katrorë. Sa paralelopipedë të fillë ka dhe sa janë sipërfaqet e tyre?

4. Në shportë janë çokolatat. Marrim gjysmën e të gjitha çokolatave dhe gjysmën e një çokolade, pastaj i marrim gjysmën e çokolatave të mbetura dhe gjysmën e një çokolade. Përfundimisht, marrim gjysmën e çokolatave të mbetura dhe gjysmën e një çokolade. Në shportë ka mbetur 1 çokolatë. Sa çokolata kishte në fillim në shportë?

